




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Kandidatët pjesëmarrës për aplikim për licencë të KPM-së, në bazë të konkursit të shpallur më 27 shtator 2019, për Komunën e Hanit të Elezit:

Kandidati: "Criteria Network" SH.P.K.
Nr. unik identifikues: 810848062
Përfaqësuar nga: Blerim Kroma
Emri i propozuar: Radio Criteria
Adresa: Rr/Mati 1, Lin Projekt, Hyrja 8, Nr.41
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R1

Kandidati: Radio Urban - FM O.P.
Nr. unik identifikues: 811285750
Përfaqësuar nga: Adus RAMADANI
Emri i propozuar: Radio Urban FM
Adresa: Rr/ Garibaldi, Nr 5/11
Prishtinë
Kodi i kandidatit: R2

Ref: 1912/1441/LIC/ni

VENDIM

me kërkesat e kandidatëve për licencë të radios për transmetim të radio programeve, me mbulim që i përket kategorisë lokale në Komunën e Hanit të Elezit

Fakte

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.
2. Në bazë të Ligjit nr. 04/L-44 (Ligji për KPM), neni 3, paragrafi 2.1, KPM licencon transmetuesit publik e privat dhe i ripërtërin licencat, duke iu dhënë subjekteve të autorizuar të drejtën e përdorimit të frekuencave në Spektrin e Frekuencave të Transmetimit si dhe licencon të gjitha shërbimet mediale audiovizuale.
3. Neni 3, paragrafi 2.6, i Ligjit për KPM-në, i jep kompetencë dhe e obligon KPM-në që të nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe shërbimeve mediale audiovizuale, të cilat shërbejnë për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
4. Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, më 27 shtator 2019, KPM-ja ka shpallur konkurs publik për dhënien e licencave të reja për transmetim lokal të radio programeve në Komunën e Hanit të Elezit. Konkursi ka qenë i hapur nga data 27 shtator 2019 deri më datën 27 tetor 2019, ora 16:00, ndërsa më datën 25 tetor 2019, KPM-ja ka marrë vendim për zgjatjen e afatit të konkursit deri më datën 8 nëntor 2019, ora 16:00.

5. Konkursi publik është zhvilluar mbi bazën e Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, të nevojshme për plotësimin dhe parashtrimin e aplikimit për licencë të KPM-së që janë:
- Rregullorja për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (KPM-2017/02);
 - Rregullorja për vlerësimin e aplikacioneve (KPM-2014/02); dhe
 - Rregullorja për Tarifën Vjetore për Licencë (KPM-2017/06).
6. Kandidati R1 ka dorëzuar aplikacionin e kompletuar në KPM, brenda afatit dhe në pajtim me konkursin publik. Ndërsa, kandidati R2 ka dorëzuar aplikacionin brenda afatit për aplikim, mirëpo jo të kompletuar në KPM, në pajtim me konkursin publik.

Arsyetim

7. Vendimi i KPM-së për dhënien e licencave të reja është bërë mbi bazën e nevojave të publikut dhe kapaciteteve të lira frekuencore në ato komuna të Republikës së Kosovës, ku është vlerësuar se ka mungesë të shërbimeve mediale radio me mbulim lokal dhe regional, si dhe në ato komuna ku është kërkuar që të krijohet mundësi për pluralizëm medial.
8. Neni 21, paragrafi 1, i Ligjit për KPM-në, thekson se: *“Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
9. Neni 22, paragrafi 4, pikat: 4.1, 4.2, 4.3, 4.4 dhe 4.5, të Ligjit për KPM-në, përcakton kriteret kryesore mbi bazën e të cilave KPM-ja vlerëson aplikacionet e kandidatëve për dhënien e licencës së KPM-së.
10. Në takimin e mbajtur më datën 6 dhjetor 2019, si dhe në takimet tjera pasuese, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve ka konstatuar se aplikacioni i kandidatit R1 është dorëzuar i kompletuar në KPM dhe në pajtim me Rregulloren KPM-2017/02, duke i plotësuar në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
11. Në takimin e mbajtur më datën 6 dhjetor 2019, si dhe në takimet pasuese, Komisioni për Vlerësimin e Aplikacioneve ka konstatuar se aplikacioni i kandidatit R2 nuk është dorëzuar i kompletuar në KPM dhe në pajtim me Ligjin për KPM-në dhe Rregulloren KPM-2017/02, duke mos arritur t’i plotësojë në tërësi kushtet kualifikuese për licencë të KPM-së.
12. Kandidati R2 nuk ka arritur që t’i plotësojë kushtet dhe kriteret kualifikuese për licencë të KPM-së, për shkak se:
- a) Kandidati ka dështuar të ofrojë deklaratatë për njërin nga pronarët, se nuk mbanë poste publike të zgjedhur apo emëruar, poste udhëheqës apo ekzekutive në parti politike apo organizatë fetare.

